

**STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“B.S ELEZAJ SHPK”**

Ne baze e ne zbatim te ligjit

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshtë referohet si “Ligji Per Shoqerite”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

veprimtaria e shoqerise

“B.S ELEZAJ SHPK” sh.p.k.

do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejtien dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane :

1. **VERMOSH ELEZAJ** , shtetas Shqiptar , lindur me 13 mars 1972 ne Bruz Mal Kruje , banues ne Kamez, Shqiperi , mbajtes i leternjoftim nr 033814919 dhe numer personal H20313117O , madhor dhe me zotesi juridike te plete per te vepruar.

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është **B.S ELEZAJ SHPK**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3
Selia e Shoqerise**

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: **Tirane Lagjia administrative Bathore ,nr 7 ,Bashkia Kamez ,Rruga “ Delvine”, objekti nr 17/1 .**
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikes se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.



Neni 4
Forma ligjore

4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per një periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

Neni 6
Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise "**B.S ELEZAJ SHPK**" , konsiston ne :

1. Zbatim i veprave ndërtimore si vijon : Punime karpenterie, ndërtime me karakter civil dhe industrial ,perpunim vendosje dhe lidhje hekuri industrial , punime gërmimi dhe sitemimi dhei ,tarracime terrenesh , rikonstruksione godinash civile dhe industriale ,veshje fasadash , ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh ,ndërtime rrugësh ,asfaltim,hapje kanalesh si dhe cdo ndërtim tjeter me karakter civil dhe industrial .
 2. Lidhje hekuri , punime te muratures , suvatimeve , shtrim pllaka dhe gjithe proceset e ndertimeve civile dhe industriale .
- 6.2. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

PJESA II
KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT

Neni 7
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mijë) Leke i marre persiper dhe i nenshkuar nga ortaket.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote e cila zoterohej nga ortaket si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkuara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
VERMOSH ELEZAJ	1	100,000	100%
Total	1	100,000	100%



Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar

8.1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 9 Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korrensponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën përmarrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10 Fitimi dhe kalimi i kuotave

- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashegimise
 - d. dhurimit
 - e. cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrata do behet me shkrim.

Neni 11 Detyrimet e Ortakëve

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.



PJESA IV
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12
Të drejtat e asamblesë së per gjithshme

- 12.1 Asambleja e per gjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e per gjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e per gjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
 - (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
 - (g) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
 - (h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqerise si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
 - (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
 - (l) të vendosë për investimet;
 - (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
 - (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
 - (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
 - (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
 - (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
 - (r) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - (t) percaktimin e shperblimeve per likuiduesit, ekspertet kontabel;
 - (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët;
 - (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
 - (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
 - (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
 - (y) miratimin e cdo cështje tjeter zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së per gjithshme në përpunje me ligjin dhe këtë Statut.
 - (z) Marrjen e huave ne emer te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase



(aa) Lidhjen e mareveshjeve per dhenien e huave

- 12.4 Asambleja e per gjithshme do t^e ket^e t^e drejt^e t^e vendos^e mbi cdo c^eshtje q^e tejkalon aktivitetin e p^erditsh^em t^e shoq^eris^e.

Neni 13
Vendimet e asambles^e s^e per gjithshme

- 13.1 Vendimet e renditura p^ersa i p^erket ndryshimit t^e statutit, zmadhimin ose zvog^elimin e kapitalit t^e regjistruar, shp^erndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoq^eris^e merren me $\frac{3}{4}$ e votave t^e ortak^ee pjesemarr^es.

Neni 14
Thirrja e asambles^e s^e per gjithshme

- 14.1 Asambleja e per gjithshme do t^e thirret nga administrator^et t^e pakt^en nj^eher^e n^e vit n^e selin^e e Shoq^eris^e ose ne cdo vend tjeter n^ese percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortak^et t^e cilet perfaq^esojn^e t^e pakt^en 20 p^er qind t^e totalit t^e votave ne asamblen^e e p^ergjithshme t^e shoq^eris^e mund t[']i drejtojn^e administrator^eve nj^e k^erkесe me shkrim ose n^ep^ermjet post^es elektronike p^er t^e thirrur asamblen^e e per gjithshme. N^e k^erkесen drejtar administrator^eve mund t^e p^erfshihen dhe c^eshtjet e posacme t^e rendit t^e dit^es.
- 14.3 Asambleja e per gjithshme do t^e thirret me an^e t^e nj^e njoftimi t^e shkruar t^e d^erguar nga administrator^et, njoftim ky i cili duhet t^e merret nga p^erfaq^esuesit e ortak^ee n^ep^ermjet nj^e letre rekomande, email , telexi apo faksi jo m^e pak se 7 (shtat^e) dit^e p^errpara dat^es s^e caktuar t^e mbledhjes. Njoftimi i shkruar do t^e regjistrohet n^e librin e procesverbalit t^e shoq^eris^e. Gjithashtu, asambleja e per gjithshme mund t^e thirret n^ep^ermjet post^es elektronike me t^e nj^ejtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi p^er takimin e asambles^e s^e per gjithshme do t^e tregoj^e dat^en koh^en dhe vendin e takimit si dhe c^eshtjet e rendit t^e dit^es.
- 14.5 N^ese data p^er mbledhjen e ardhshme t^e asambles^e esht^e vendosur n^e takimin e fundit dhe t^e gjith^e ortak^et kan^e q^en^e prezant^e, at^eher^e do t^e g^yykohet sikur njoftimi esht^e d^erguar.
- 14.6 N^ese t^e gjith^e ortak^et jan^e prezant^e n^e asamblen^e e ortak^ee, at^eher^e vendimet mund t^e merren dhe n^e munges^e t^e p^erbushjes s^e k^erk^esave formale t^e caktuara m^e sip^er n^ese t^e gjith^e ortak^et jan^e dakord.

Neni 15
Vendimet e marra në asamblenë e pergjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e pergjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

Neni 16
Drejtimi i mbledhjes se asamblese se pergjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se pergjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre.

Neni 17
Procesverbali i mbledhjes së asamblese se pergjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se pergjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve.



Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Neni 18 **Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e per gjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administritimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënen dhe marrien e paradhënieve;
 - (f) dhënen e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
 - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërbllimeve dhe pagesave të stafit;
 - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërbllimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje



- arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
 - (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
 - (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dika e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
 - (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
 - (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
 - (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
 - (p) marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6. Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritje:

1. **VERMOSH ELEZAJ**, shtetas Shqiptar, lindur me 13 mars 1972 ne Bruz Mal Kruje, banues ne Kamez, Shqiperi, mbajtes i leternjoftim nr 033814919 dhe numer personal H20313117O, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar

PJESA VI **VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

Neni 19 **Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare**

- 19.1 Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të cdo viti finanziar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;

- (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
 - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm përmiratim.

Neni 20

Fitimi i Shoqërie

- 20.1. Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2. Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e otakëve dhe do të dorëzohet në organet tativore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21 Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjeter;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridikcion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpérndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII TE PERGJITHSHME

Neni 22 Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiken t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një



marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikSION përkatës.

22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale.

Tirane me 30 qershori 2022

ORTAKU I VETEM

VERMOSH ELEZAJ

Vermosh Elezaj
